

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I  
Z Y R T A R

---

vëllimi 9    numër 11    nëntor 2007

Data e botimit 26.11.2007



## P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 63, datë 31.10.2007 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes"	5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 66, datë 14.11.2007 "Për miratimin e rregullores "Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të administrimit të thesarit (ATM)"	6
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 67, datë 14.11.2007 "Për një ndryshim në strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë"	16
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 68, datë 14.11.2007 "Për emërimin e Drejtorit të Departamentit të Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë"	20
5. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 9, Numër 1, Janar 2007	21
6. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 9, Numër 2, Janar 2007	21
7. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 9, Numër 3, Shkurt 2007	21
8. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 9, Numër 4, Prill 2007	21
9. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 9, Numër 5, Maj 2007	22
10. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 9, Numër 6, Qershor 2007	22
11. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 9, Numër 7, Korrik 2007	23
12. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 9, Numër 8, Shtator 2007	24
13. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 9, Numër 9, Shtator 2007	24
14. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 9, Numër 10, Tetor 2007	25





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 63, datë 31.10.2007

PËR  
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË  
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 6,00 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (repo dhe repo të anasjellta).
2. Ngarkohen Departamenti i Politikës Monetare dhe Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 66, datë 14.11.2007

PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI FUNKSIONIMIN E SISTEMIT  
KONTABËL DHE TË ADMINISTRIMIT TË THESARIT (ATM)"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Këshilli Mbiqëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të administrimit të thesarit (ATM)", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit me zbatimin e këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 22, datë 15.03.2006 për miratimin e rregullores "Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të administrimit të thesarit (ATM)".
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

## RREGULLORE

### “MBI FUNKSIONIMIN E SISTEMIT KONTABËL DHE TË ADMINISTRIMIT TË THESARIT (ATM)”

#### KREU I TË PËRGJITHSHME

##### NENI 1 OBJEKTI

Kjo rregullore ka për qëllim të sigurojë mirëfunksionimin e sistemit kontabël dhe të administrimit të thesarit (ATM), nëpërmjet përcaktimit dhe ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive midis njësive kryesore organizative përdoruese të sistemit ATM dhe koordinimit midis tyre.

##### NENI 2 BAZA JURIDIKE

Kjo rregullore nxirret në mbështetje dhe në zbatim të:

- a) ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe
- b) akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

##### NENI 3 PËRKUFIZIME

Në zbatim të kësaj rregulloreje termit e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) “Banka” – është Banka e Shqipërisë.
- b) “Njësi” – është departamenti, si njësi organizative e Bankës së Shqipërisë. Në kuptim të kësaj rregulloreje, do të përdoren termit “njësi” dhe “departament”, duke nënkuptuar njëri-tjetrin.
- c) Sistemi (ATM) – është “Sistemi kontabël dhe i administrimit të thesarit (ATM)”, si bashkësia e tërë sistemeve operacionale, e bazës së të dhënave, e instruksioneve dhe e manualeve të përdorimit të sistemeve të informacionit të realizuar si pjesë e projektit ATM, të cilat do të jenë subjekt i përmirësimeve dhe i ndryshimeve të vazhdueshme.
- d) “Sisteme operacionale” – janë programet aplikative, pjesë të projektit ATM, qëllimi dhe përdorimi i të cilave është i lidhur me automatizimin e anës operacionale të Bankës dhe që aktualisht konsistojnë në: Sistemin Kontabël (Oracle Financial), Sistemin e

Administrimit të Tregtimit ("InFoRex"), Sistemin e Administrimit të Llogarive "Loro" ("LORO"), Sistemin e Administrimit të Kredive të Punonjësve ("SLM") si dhe Sistemin e Inventarizimit të Arkave ("CBR").

- e) "Nënsisteme ose module operacionale" – janë programet aplikative, pjesë të sistemeve operacionale dhe që aktualisht konsistojnë në: Modulin e të Pagueshmeve ("AP"), Modulin e të Arkëtueshmeve ("AR"), Modulin e Administrimit të Mjeteve Fikse ("FA"), që janë pjesë e Sistemit Kontabël (Oracle Financial) dhe Modulin e Kartëmonedhave, që është pjesë e Sistemit të Administrimit të Tregtimit (InFoRex).
- f) "Transaksion në sistem" – është bashkësia e të dhënave të regjistruara në sistem për të përshkruar një ngjarje financiare, që identifikohet automatikisht nga sistemi në mënyrë të vetme.
- g) "Manuallet e funksionimit të sistemit" – janë materialet e shkruara shoqëruese standarde të prodhuesve të sistemeve si dhe ato të personalizuar për Bankën, nga firma Compaq, zbatuese e projektit. Manuallet janë subjekt i ndryshimeve, për të reflektuar në çdo kohë ndryshimet (përmirësimet) në sistemet përkatëse të informacionit.
- h) "Sisteme të jashtme" – janë sistemet apo nënsistemet e tjera, si AIPS, AECH, SWIFT, REUTERS, Bloomberg, të cilat nuk janë pjesë e arkitekturës së sistemit ATM.
- i) "Ndërfaqet" – janë produkte software, të cilat realizojnë bashkëveprimin midis sistemeve/nënsistemeve, pjesë përbërëse të sistemit ATM me njeri- tjetrin apo ato që realizojnë bashkëveprimin e këtyre të fundit me sistemet e jashtme.  
"Përdoruesit e sistemit ATM" – janë punonjësit e Departamentit të Kontabilitetit dhe Financës, Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Departamentit të Operacioneve Monetare, Departamentit të Emisionit dhe të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, të cilët në zbatim të funksioneve apo të detyrave të tyre përdorin këto sisteme. Punonjës nga departamente të tjera mund të përcaktohen në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje. Termi përdorues në këtë rregullore do të nënkuptojë përdorues sistemi/nënsistemi.
- j) "Profil i përdoruesit" – është bashkësia e të drejtave në sistem/nënsistem që i jepen një përdoruesi sistemi/nënsistemi, në funksion të detyrave të tij. Këto të drejta përcaktohen nga kujdestari i sistemit dhe janë subjekt i rishikimit periodik.  
Profilet e përdoruesve realizohen teknikisht nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit.
- k) "Kujdestar i një sistemi" – është njësi organizative e cila miraton listën e përdoruesve dhe profilet e tyre, ndjek operimin e përgjithshëm mbi sistemin, si dhe inicion dhe pranon ndryshimet apo përmirësimet e nevojshme në lidhje me të.
- l) "Help Desk" – është shërbimi i asistencës së përdoruesve të ndryshëm të sistemit ATM, dhe që ka për qëllim ndjekjen dhe zgjidhjen e problemeve teknike apo funksionale që lidhen me



mosfunksionimin e rregullt apo me përdorimin e gabuar të sistemit.

- m) "Ruajtja dhe mbrojtja" – është bashkësia e të gjitha rregullave, procedurave, masave që lidhen me mbrojtjen e sistemit ATM dhe që janë në zbatim të "Politikës së Sigurisë së Informacionit" në Bankë.
- n) "AIPS" – është sistemi shqiptar i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe.
- o) "AECH" – është sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël.
- p) "Të dhënat kryesore të sistemit të tregtimit InFoRex" – janë të dhënat për llogaritë e tipit "nostro", rezervat e detyrueshme, kurset e këmbimit, normat e interesit, vlerat e tregut të letrave me vlerë etj..
- q) "Të dhënat kryesore të sistemit CBR (Cash Book Registry)" - janë tipet e arkave, tipet e prerjeve të monedhave dhe të kartëmonedhave me kategorizimet përkatëse të tyre, si dhe tipet e transaksioneve mbi arkat.

## KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT ATM SIPAS DETYRAVE TË ÇDO DEPARTAMENTI

### NENI 4 FUNKSIONET E PËRDORUESVE TË SISTEMIT ATM

1. Përdoruesit e sistemit ATM kryejnë një ose disa nga funksionet e mëposhtme:
  - a) krijojnë transaksione me vlerë të çdo tipi në sistemin ATM;
  - b) përdorin informacionet e gjeneruara prej sistemit ATM; dhe
  - c) sigurojnë mbështetjen dhe mirëmbajtjen teknike të sistemit ATM.

### NENI 5 PROCEDURA E CAKTIMIT TË PËRDORUESVE

1. Kujdestarët e sistemeve, pas propozimit me shkrim të drejtuesit të departamentit në të cilin bën pjesë përdoruesi, përcaktojnë përdoruesit si dhe profilet e tyre në sisteme/nënsisteme. Përcaktimi i kufizimeve dhe i profileve të përdoruesve do të kryhet në përputhje me parimin e minimizimit të të drejtave dhe me nivelet e sigurisë, të përcaktuara në sistemet përkatëse.
2. Administratori përkatës, në varësinë e të cilit ndodhet departamenti kërkues, mund të përcaktojë përdorues nga departamente të tjera, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.
3. Lista e përdoruesve së bashku me profilet e tyre, e nënshkruar

nga drejtori i departamentit kërkues, kujdestari dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit përgatitet në 2 (dy) kopje. Një kopje e kësaj liste mbahet nga kujdestari i sistemit, ndërsa kopja tjetër mbahet në Zyrën e Administrimit të Sigurisë, pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit.

#### NENI 6

#### DETYRAT E DEPARTAMENTIT TË KONTABILITETIT DHE FINANCËS

Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës është kujdestar i sistemit kontabël (Oracle Financial) me të gjitha nënsistemet e tij – (Oracle GL, Budget, Oracle Payable, Oracle Receivable, Oracle Fixed Assets), si dhe i sistemit të administrimit të kredive të punonjësve (SLM). Ky departament ushtron detyrat si më poshtë:

- a) administron llogaritë e Librit të Madh dhe të gjithë aktivitetin e lidhur me to;
- b) pasqyron në Librin e Madh (Oracle GL), në përputhje me parimet e kontabilitetit, ngjarjet financiare të aktivitetit administrativ ditor të Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë aktivitetin e nënmoduleve: Oracle Payables, Oracle Receivables dhe Oracle Fixed Assets, sistemeve InFoRex, Loro, CBR, SLM, si dhe të sistemeve të tjera të jashtme: AIPS dhe AECH;
- c) realizon kontrole mbi saktësinë dhe pasqyrimin kontabël të veprimtarisë financiare të Bankës, nëpërmjet sistemeve/nënsistemeve të ATM në Librin e Madh;
- d) rakordon çdo ditë llogaritë e pastrimit midis sistemeve InFoRex dhe AIPS;
- e) në rast konstatimi parregullsish në hedhjen e veprimeve njofton menjëherë departamentin iniciues të veprimit dhe kujdestarin e sistemit/nënsistemit përkatës, me telefon, e-mail ose shkresë zyrtare, për parregullsitë e hasura gjatë kontrollit të realizuar dhe bashkëpunon me ta për sistemimin e tyre. Departamenti iniciues i veprimit merr masa të menjëhershme dhe është përgjegjës për sistemimin përfundimtar të parregullsive të evidentuara;
- f) në bashkëpunim me njësitë e tjera të përfshira në sistem, përcakton dokumentacionin e nevojshëm kontabël si dhe rrjedhën e tij;
- g) në bashkëpunim me njësitë e tjera të përfshira në sistem, harton skemat kontabël si dhe realizon implementimin dhe ndjekjen e produkteve të reja financiare dhe të politikave të reja kontabile;
- h) realizon hapjen dhe mbylljen e periudhave kontabël dhe procedurat e lidhura me këtë veprimtari;
- i) njofton Departamentin e Teknologjisë së Informacionit për problemet që dalin gjatë funksionimit të moduleve përkatëse, kur gjykon që zgjidhja e tyre kërkon ndihmë të specializuar; dhe
- j) pasqyron aktivitetin e degëve të Bankës në Librin e Madh.

## NENI 7

### DETYRAT E DEPARTAMENTIT TË SISTEMEVE TË PAGESAVE

Departamenti i Sistemeve të Pagesave është kujdestar i Sistemit të Administrimit të Llogarive "Loro" ("LORO"). Ky departament ushtron detyrat si më poshtë:

- a) administron llogaritë speciale dhe llogaritë e tjera të Ministrisë së Financave, llogaritë e bankave në valutë, si edhe të institucioneve të tjera financiare në modulën Loro dhe të gjithë aktivitetin e lidhur me to. Bën rakordimin e këtyre llogarive me llogaritë e Librit të Madh, në fund të çdo muaji;
- b) pasqyron, aktivitetin ditor në llogaritë "Nostro" e "Loro";
- c) realizon hapjen/mbylljen ditore të tij duke u kujdesur që procesi i mbylljes, të realizohet pas përfundimit të veprimtarisë në sistemin AIPS;
- d) ndjek nga brenda aplikimit, ndërfaqen e përdoruesit InFoRex-AIPS dhe InFoRex-SWIFT, përkatësisht (1) për verifikimin e shlyerjes në AIPS të transaksioneve të iniciuara në InFoRex, dhe (2) për gjenerimin e mesazheve SWIFT nga/për InFoRex;
- e) në rast konstatimi parregullsisht në hedhjen e veprimeve njofton menjëherë departamentin iniciues të veprimit dhe kujdestarin e sistemit/nënsistemit përkatës, me telefon, e-mail ose shkresë zyrtare, për parregullsitë e hasura gjatë kontrollit të realizuar dhe bashkëpunon me ta për sistemimin e tyre. Departamenti iniciues i veprimit merr masa të menjëhershme dhe është përgjegjës për sistemimin përfundimtar të parregullsive të evidentuara;
- f) njofton Departamentin e Teknologjisë së Informacionit për problemet që dalin gjatë funksionimit të sistemit Loro, kur gjykon që zgjidhja e tyre kërkon ndihmë të specializuar; dhe
- g) mbështet Departamentin e Kontabilitetit dhe Financës në zbatimin e skemave kontabël për produktet e reja, me hapjen e llogarive apo tipe të reja transaksionesh në modulën LORO.

## NENI 8

### DETYRAT E DEPARTAMENTIT TË OPERACIONEVE MONETARE

Departamenti i Operacioneve Monetare është kujdestar i sistemit të tregtimit (InFoRex). Ky departament ushtron detyrat si më poshtë:

- a) administron portofolet e instrumenteve në sistemin e tregtimit InFoRex, si dhe gjithë aktivitetin e lidhur me to;
- b) kujdeset që aktiviteti ditor në InFoRex, që ka lidhje me llogaritë në lekë, të përfundojë brenda kufijve kohorë të lejuar të aktivitetit në AIPS;
- c) administron dhe mirëmban, në mënyrë të vazhdueshme, të dhënat kryesore të sistemit të tregtimit dhe realizon procedurat e hapje/mbylljes ditore të tij, si dhe ndjek funksionimin e ndërfaqeve me

- sistemet REUTERS, BLOOMBERG;
- d) mbështet Departamentin e Kontabilitetit dhe Financës në krijimin e kushteve për administrimin dhe kontabilizimin e produkteve të reja;
  - e) njofton Departamentin e Teknologjisë së Informacionit për problemet që dalin gjatë funksionimit të moduleve përkatëse, kur gjykon që zgjidhja e tyre kërkon ndihmë të specializuar; dhe
  - f) kur konstatohen parregullsi, pas mbylljes së aktivitetit ditor, në përputhje me manualet e veprimtarisë së departamentit në fjalë, sistemon veprimin duke njoftuar në të njëjtën kohë Departamentin e Sistemeve të Pagesave dhe Departamentin e Kontabilitetit dhe Financës.

## NENI 9

### DETYRAT E DEPARTAMENTIT TË EMISIONIT

Departamenti i Emisionit është kujdestar i sistemit të administrimit të arkave (CBR). Gjithashtu, punonjësit e këtij departamenti janë edhe përdorues të sistemit InFoRex, për modulën e kartëmonedhave. Ky departament ushtron detyrat si më poshtë:

- a) administron librat e arkave dhe i rakordon periodikisht ato me Librin e Madh në bashkëpunim me Departamentin e Kontabilitetit dhe Financës;
- b) pasqyron rregullisht aktivitetin ditor të arkave;
- c) regjistron në modulën InFoRex kërkesat për furnizime *cash* dhe kujdeset për eksportin e tyre në CBR, pas shlyerjes së tyre në AIPS;
- d) ndjek në ndërfaqen InFoRex-AIPS, shlyerjen në AIPS të transaksioneve të iniciuara në InFoRex për transaksionet që lidhen me kartëmonedhat;
- e) kujdeset që aktiviteti ditor në modulën CBR, që ka lidhje me llogaritë në lekë dhe bankat, të përfundojë brenda kufijve kohorë të lejuar, të aktivitetit në AIPS;
- f) realizon eksportimin në Librin e Madh (Oracle GL) të aktivitetit ditor të modulit CBR, në fund të çdo dite;
- g) rakordon çdo ditë së bashku me Departamentin e Sistemeve të Pagesave, llogaritë e pastrimit të nënsistemit CBR;
- h) bën rregullimet e duhura në sistemin CBR pas marrjes së informacionit nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave, duke bërë edhe njoftimin e departamenteve përkatëse për rregullimet pas realizimit të tyre;
- i) administron dhe mirëmban në mënyrë të vazhdueshme të dhënat kryesore të sistemit CBR;
- j) mbështet Departamentin e Kontabilitetit dhe Financës në realizimin e transaksioneve të reja; dhe
- k) njofton Departamentin e Teknologjisë së Informacionit për problemet që dalin gjatë funksionimit të moduleve përkatëse, kur gjykon që zgjidhja e tyre kërkon ndihmë të specializuar.

## NENI 10

### DETYRAT E DEPARTAMENTIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ushtron detyrat si më poshtë:

- a) siguron mirëfunksionimin e sistemit ATM si dhe të bazës teknike përkatëse;
- b) ofron shërbimin e Help Desk-ut për përdoruesit e sistemit ATM;
- c) ndjek nevojat për përmirësim dhe për përditësim të vazhdueshëm të sistemeve;
- d) realizon teknikisht krijimin e përdoruesve dhe të profileve të përdoruesve në sistemin ATM, pas çdo miratimi nga kujdestarët e sistemeve përkatëse;
- e) mbështet Departamentin e Kontabilitetit dhe Financës dhe/ose njësitë e tjera në implementimin e produkteve financiare apo të politikave të reja kontabël;
- f) shërben si pikë kontakti me firmën ofruese përsa i përket mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sistemit;
- g) ndjek dhe realizon, në përputhje me "Politikën e sigurisë së informacionit", aktivitetet që lidhen me sigurimin e konfidencialitetit, të integritetit dhe të disponueshmërisë;
- h) ndjek në mënyrë të veçantë zbatimin e procedurave të administrimit të ndryshimeve në sistemet e informacionit;
- i) në bashkëpunim me kujdestarët e sistemeve ndjek procesin e rishikimit të manualeve të funksionimit të sistemit ATM; dhe
- j) realizon ruajtjen e përditshme të bazës së të dhënave (*backup-et*).

## KREU III

### MANUALET E PËRDORIMIT DHE SIGURIA E SISTEMIT ATM

## NENI 11

### MANUALET E PËRDORIMIT

1. Organizimi i brendshëm i punës brenda njësive të Bankës, të përcaktuara në nenet 6, 7, 8, 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje, përcaktohet në manualët përkatëse sipas veprimtarisë së departamenteve, të cilat hartohen dhe përditësohen në përputhje me rregulloret e brendshme të tyre dhe me manualët e përdorimit të sistemeve/nënsistemeve.
2. Në manualët e përdorimit:
  - a) përcaktohen në mënyrë të qartë dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në sisteme, aktivitetet dhe profilet e secilit përdorues së bashku me zëvendësuesit e mundshëm të tyre;
  - b) kryhet ndarja e detyrave në përputhje me rregulloren "Për nënshkrimet e autorizuara dhe kufijtë e pagesave në Bankën e Shqipërisë" si dhe me aktet e tjera të Bankës;

- c) realizohet në mënyrë maksimale ndarja e detyrave për zbatimin e parimit të kontrollit të dyfishtë;
- d) përcaktohen kufijtë e afateve kohore të përfundimit të aktivitetit ditor apo të transaksioneve të veçanta të njësisë në marrëdhënie me njësitë e tjera; dhe
- e) përcaktohen procedurat ditore dhe periodike të kontrollit, të rakordimit të aktivitetit dhe "librave" të njësisë me ato të njërive të tjera të Bankës.

## NENI 12

### SIGURIA E SISTEMIT ATM

Për zbatimin dhe mirëmbajtjen e sigurisë mbi sistemin ATM, veç rregullave që përfshihen në mënyrë të përgjithshme në manualët dhe në procedurat e sigurisë mbi sistemet e informacionit në bankë, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij sistemi, përcaktohen edhe disa rregulla specifike si më poshtë:

- a) fjalëkalimet – përdoruesit e sistemit ruajnë fshehtësinë e fjalëkalimeve të tyre (rinovojnë në mënyrë periodike ato, si dhe sa herë që mendojnë se kjo fshehtësi është kompromentuar);
- b) rishikimi i listës së përdoruesve – Zyra e Administrimit të Sigurisë pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit bashkë me kujdestarët e sistemeve, rishikojnë në mënyrë periodike (minimalisht 2 herë në vit) listën e përdoruesve si dhe të profileve të tyre;
- c) parimi i minimizimit të të drejtave - kujdestarët e sistemeve, në përcaktimin e përdoruesve si dhe të profileve të tyre, duhet të udhëhiqen nga parimi i minimizimit të privilegjeve. Për këtë arsye, çdo e drejtë që i jepet një përdoruesi të sistemit duhet të jetë plotësisht e justifikuar nga detyra funksionale e tij;
- d) parimi i kontrollit të dyfishtë – gjatë realizimit të aktivitetit mbi sistemet përdoret në mënyrë maksimale parimi i kontrollit të dyfishtë mbi çdo aktivitet. Në rastet kur teknikisht nuk është e mundur, zbatohen kontrole të rregullta periodike mbi këto aktivitete;
- e) administrimi i ndryshimeve në aplikim – të gjitha ndryshimet iniciohen dhe miratohen nga kujdestari i sistemit. Çdo ndryshim, në mënyrë të detyruar, testohet përpara se ai të zbatohet në sistemin bazë;
- f) ruajtja dhe mbrojtja e sistemeve – informacioni i regjistruar në sistemin ATM, në përputhje me karakteristikat teknike të vetë sistemeve, ruhet në çdo kohë në dy mbartës të ndryshëm informacioni, të vendosur në dy dhomat ekzistuese të kompjuterave. Aplikimi dhe bazat e të dhënave ruhen çdo ditë në shirita magnetikë; dhe
- g) kontrolli mbi konfigurimin e pajisjeve – pajisjet elektronike, të cilat do të jenë mbartëse dhe transmetuese të informacionit të nënsistemeve operacionale, ruhen dhe kontrollohen në mënyrë të veçantë. Niveli i sigurisë i këtyre pajisjeve përcaktohet nga Zyra

e Administrimit të Sigurisë pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, në bashkëpunim me kujdestarët e sistemeve, ku përdoruesit bëjnë pjesë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 67, datë 14.11.2007

PËR  
“NJË NDRYSHIM NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË BANKËS SË  
SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “gj” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Burimeve Njerëzore, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në strukturën organizative dhe numrin e punonjësve të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.79, datë 31.10.2005 “Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Struktura organizative dhe numri i punonjësve të Departamentit të Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë, ndryshojnë sipas pasqyrës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pika 2 e vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.79, datë 31.10.2005 “Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

“Numri i përgjithshëm i punonjësve të Bankës së Shqipërisë është 469 (katërqind e gjashtëdhjetenëntë), nga të cilët 387 (treqindetëdhjeteshtatë) punonjës për administratën qendrore, 22 (njëzetë e dy) punonjës për Shtypshkronjën dhe 60 (gjashtëdhjetë) punonjës për degët e Bankës së Shqipërisë”.

3. Ngarkohen Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe njësitë e tjera organizative të Bankës së Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.



4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 16.11.2007.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

## NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKËN E BANKËS SË SHQIPËRISË

(Miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.67, datë 14.11.2007.)

NR.	EMËRTIMI I VENDEVE TË PUNËS NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE	Nr. i punonjësve
1.	ADMINISTRATA QENDRORE	387
2.	ADMINISTRATA LOKALE DHE SHTYPSHKRONJA	82
	GJITHSEJ	469

## NUMRI I PUNONJËSVE DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE NË ORGANIKËN E ADMINISTRATËS QENDRORE

NR.	EMËRTIMI I VENDEVE TË PUNËS NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE	Nr. i punonjësve
1.	GUVERNATOR	1
2.	ZËVENDËSGUVERNATOR I PARË	1
3.	ZËVENDËSGUVERNATOR I DYTË	1
4.	INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM	1
5.	KABINETI I GUVERNATORIT	11
6.	ZYRAT E ADMINISTRATORËVE	7
7.	DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE	16
8.	DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE	23
9.	DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE	16
10.	DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE MONETARE	24
11.	DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES	39
12.	DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	29
13.	DEPARTAMENTI I STATISTIKËS	23
14.	DEPARTAMENTI I EMISIONIT	35
15.	DEPARTAMENTI I KONTABILITETIT DHE FINANCËS	15
16.	DEPARTAMENTI JURIDIK	12
17.	DEPARTAMENTI I KONTROLLIT	6
18.	DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË, INTEGRIMIT EVROPIAN DHE KOMUNIKIMIT	20
19.	DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT	53
20.	DEPARTAMENTI I SIGURIMIT DHE MBROJTJES	30
21.	DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR	9
22.	DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE	15
	TOTAL	387

### IX. DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES

#### STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË

(Miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 67, datë 14.11.2007.)

Nr.	Emërtimi i vendeve të punës në strukturën organizative	Nr. i punonjësve
	Drejtor Departamenti	1
A.	Spektori i Analizës dhe Inspektiveve	26
I.	Zëvendësdrejtor dhe Përgjegjës Spektori	1
II.	Zyra e Analizës	4
1.	Përgjegjës Zyre	1

2.	Specialistë	3
III.	Zyra e Inspektiveve	21
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialistë	20
B.	Sektori i Licencimit, Rregullimit dhe Standardeve	12
I.	Zëvendës drejtor dhe Përgjegjës Sektori	1
II.	Zyra e Licencimit	3
2.	Specialistë	3
III.	Zyra e Rregullimit, Interpretimit dhe Standardeve	4
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialistë	3
C.	Zyra e Regjistrimit të Kredive	4
1.	Përgjegjës Zyre	1
2.	Specialistë	3
	Gjithsej	39

Struktura organizative dhe numri i punonjësve në organikë hyn në fuqi në datën 16.11.2007.

ARDIAN FULLANI  
KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 68, datë 14.11.2007

PËR  
EMËRIMIN E DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT TË KËRKIMEVE TË BANKËS  
SË SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "h" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe të rregullores "Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendimin nr 21, datë 16.05.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me propozim të Departamentit të Burimeve Njerëzore, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të emërojë në funksionin e Drejtorit të Departamentit të Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë, zotin Altin Tanku.
2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 16.11.2007.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 9, NUMËR 1, JANAR  
2007

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.01, datë 17.01.2007 "Për miratimin e "Kalendarit të mbledhjeve dhe programit të punës të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.03, datë 17.01.2007 "Për miratimin e udhëzimit "Mbi procedurat e shtypjes, të rishtypjes dhe të emetimit të monedhave metalike dhe kartëmonedhave për qëllime numizmatike, nga Banka e Shqipërisë"".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.04, datë 17.01.2007 "Për një ndryshim në rregulloren "Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore"".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 9, NUMËR 2, JANAR  
2007

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.05, datë 31.01.2007 "Për miratimin e deklaratës së politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2006".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.07, datë 31.01.2007 "Për një ndryshim në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.08, datë 31.01.2007 "Për zgjatjen e afatit njëvjeçar të vlefshmërisë së miratimit paraprak të licencës për të ushtruar veprimtari bankare, bankës së propozuar "Banka e Parë e Investimeve-Shqipëri sh.a."".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 9, NUMËR 3, SHKURT  
2007

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.10, datë 14.02.2007 "Për transferimin e pronësisë të një pjese të aksioneve të kapitalit aksioner të bankës Credins sh.a.".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.12, datë 14.02.2007 "Për një ndryshim në vendimin nr. 93, datë 13.12.2006 të Këshillit Mbikëqyrës "Për miratimin e rregullores "Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes"".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.14, datë 01.03. 2007 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri"".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 9, NUMËR 4, PRILL 2007

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.16, datë 04.04.2007 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes

- dhe të anasjellta të riblerjes”.
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.17, datë 04.04.2007 “Për miratimin e rregullores “Për fondin e pensionit suplementar të Bankës së Shqipërisë””.

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 9, NUMËR 5, MAJ  
2007

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.19, datë 02.05.2007 “Për miratimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë “Mbi gjendjen e ekonomisë në tremujorin e parë të vitit 2007””.
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.20, datë 02.05.2007 “Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes”.

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 9, NUMËR 6,  
QERSHOR 2007

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 16.05. 2007 “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë””.
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 22, datë 16.05.2007 “Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes” të miratuar me vendimin nr. 93, datë 13.12.2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar”.
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 23, datë 16.05.2007 “Për disa ndryshime në kontratën - tip “Për marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes të letrave me vlerë”, miratuar me vendimin nr. 13, datë 09.02.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar”.
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 24, datë 16.05.2007 “Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi kushtet e veçanta të punës në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 26.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar”.
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 25, datë 16.05.2007 “Për një ndryshim në rregulloren “Për procedurat e botimeve në Bankën e Shqipërisë” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 64, datë 30.08.2006”.
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 26, datë 06.06.2007 “Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes”.
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 27, datë 06.06.2007 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 59, datë 26.07.2006 “Për rishtypjen kartëmonedhës shqiptare, me kurs ligjor””.
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 28, datë 06.06.2007 “Për një

- shtesë në vendimin nr. 95, datë 13.12.2006 "Për miratimin e disa karakteristikave të konfigurimit të kartëmonedhës shqiptare me vlerë nominale 2000 lekë, me kurs ligjor".
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 06.06.2007 "Mbi konfigurimin e kartëmonedhës me vlerë nominale 2000 lekë, me kurs ligjor".
  10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 30, datë 06.06.2007 "Për miratimin e transferimit të pronësisë së 80 për qind të aksioneve në kapitalin aksioner të Bankës Amerikane të Shqipërisë sh.a., nga fondi Shqiptaro-Amerikan i ndërmarrjeve tek Intesa Sanpaolo s.p.a., Itali".
  11. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 31, datë 06.06.2007 "Për miratimin e rregullores "Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutator".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 9, NUMËR 7, KORRIK  
2007

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 33, datë 27.06.2007 "Për rritjen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 35, datë 27.06.2007 "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare "Bankës së Parë të Investimeve, Albania sh.a."".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.36, datë 04.07.2007 "Për miratimin e ndryshimit të pjesëmarrjes influencuese të aksioneve në Bankën Popullore sh.a., nëpërmjet shitjes së 75 për qind plus 1 aksion tek Societe Generale, Francë".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 37, datë 18.07.2007 "Për disa ndryshime në strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë".
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 38, datë 18.07.2007 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e regjistrit të kredive në Bankën e Shqipërisë".
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 39, datë 18.07.2007 "Për pranimin e depozitave të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në Bankën e Shqipërisë".
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 40, datë 19.07.2007 "Për miratimin e Deklaratës së Politikës Monetare të Bankës së Shqipërisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2007".
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 41, datë 19.07.2007 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 9, NUMËR 8,  
SHTATOR 2007

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 42, datë 29.08.2007 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 43, datë 29.08.2007 "Për miratimin e transferimit të pronësisë të aksioneve të kapitalit aksioner të Bankës Italo Shqiptare sh.a., nga aksioneri SanPaolo IMI S.p.A. tek aksioneri Intesa Sanpaolo S.p.A.".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 44, datë 29.08.2007 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave të Bankës së Shqipërisë".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 45, datë 29.08.2007 "Për lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë".
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 46, datë 12.09.2007 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë" miratuar me vendimin nr. 108, datë 24.12.2003, i ndryshuar".

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 9, NUMËR 9,  
SHTATOR 2007

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 50, datë 26.09.2007 "Për rritjen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 51, datë 26.09.2007 "Për miratimin e deklaratës së Bankës së Shqipërisë "Mbi stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 53, datë 26.09 .2007 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 54, datë 26.09.2007 "Për miratimin e rregullores "Mbi rregullat e brendshëm të funksionimit të sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS".
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 55, datë 26.09 .2007 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël - AECH".
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 56, datë 26.09.2007 "Për miratimin e rregullores "Mbi rregullat e brendshëm të funksionimit të sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH".



TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 9, NUMËR 10, TETOR  
2007

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 57, datë 15.10.2007 "Për miratimin e rregullores "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja"".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 15.10.2007 "Për miratimin e Sistemit Raportues të Unifikuar – SRU për degët e bankave të huaja".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 61, datë 15.10.2007 "Për "Pranimin e shoqërisë "Visa", si pjesëmarrës i tërthortë për shlyerje në sistemin AIPS"".





Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.

Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;

Faks : 355-4-223558

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.

Tirazhi: 340 kopje